

Përschëndetje,

Në zbatim të dispozitave të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe në bazë të informacionit që më është vënë në dispozicion ju informoj si më poshtë:

- Në çfarë faze ndodhen punimet për rindërtimin/rikonstruksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve?

Përgjigje: Në pikën 2 dhe 3 të Urdhërit nr. 550, datë 31.08.2021 të Ministrisë së Kulturës "Për miratimin e lejes për zhvendosjen e përkohshme të objekteve pasuri kulturore, pjesë e fondit artistik të Galerisë Kombëtare të Arteve në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar", përcaktohet se: "Leja për zhvendosjen e përkohshme është e vlefshme për një afat jo më vonë se 30 ditë pas datës së nënshkrimit të certifikatës së marrjes në dorëzim të përkohshëm të ambientit të rikonstruksionit të Galerisë Kombëtare të Arteve. Sistemimin e punonjësve të administratës së Galerisë Kombëtare të Arteve në ambientet e Albafilm sh.a. deri në përfundim të rikonstruksionit të GKA-së".

Në vijim, pas zhvendosjes së veprave të artit, pasuri kulturore, dhe punonjësve të administratës, në zbatim të VKM-së nr. 494, datë 30.07.2021 godina i është dorëzuar në administrim Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Ju informojmë se Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka qenë palë në specifikimet teknike dhe as në procesin e lidhjes së kontratës publike. Në këtë kuadër, Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka asnjë informacion mbi ecurinë e projektit të restaurimit, dhe as të dhëna mbi fazën e punimeve, apo disponimin e ndonjë akti mbi shtyrjen e afatit të punimeve. Gjithashtu punonjësit e GKA-së nuk kanë të drejtë akses në kantierin e ndërtimit.

Për informacion të mëtejshëm mund t'i drejtoheni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

- Kur parashikohet përfundimi i punimeve?

Përgjigje: Siç ju sqaruam dhe më lart Galeria Kombëtare e Arteve është në pamundësi t'ju informojë kur do të përfundojmë punimet pasi në zbatim të VKM-së nr. 494, datë 30.07.2021 godina i është dorëzuar në administrim Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Për informacion të mëtejshëm mund t'i drejtoheni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

- Kopje të kontratës së lidhur për rindërtimin/rikonstruksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve.

Përgjigje: Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka qenë palë në specifikimet teknike dhe as në procesin e lidhjes së kontratës publike, pra nuk jemi palë në kontratën e lidhur për rindërtimin/rikonstruksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve.

Për informacion të mëtejshëm mund t'i drejtoheni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ju falënderojmë dhe urojmë punë të mbarë!